Kuvendi i Komunës Klinë
Komiteti për Politikë dhe Financa
01Nr 06-32590 */26*
Klinë, dt: 13.10 */26*

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e shtatë e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 09.09.2026, me fillim në orën 09:00, në sallën e Kuvendit të Komunës.

Mbledhjen e hapi kryesuesi, z. Enver Berisha, i cili përshëndeti nënkryetarin e komunës, z. Fadil Gashi, drejtorin e Financave, z. Faruk Smajli, drejtorin e Urbanizmit, z. Enver Berisha, si dhe anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa.

Kryesuesi prezantoi rendin e ditës:

1. **Arsyetimi i mungesave;**
2. **Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e fundit e Komitetit për Politikë dhe Financa;**
3. **Shqyrtimi i draft-buxhetit komunal për vitin 2027 (ref.drejt.Fin.);**
4. **Shqyrtimi i kërkesave të pranuara në Komitetin për Politikë dhe Financa gjatë periudhës korrik–gusht 2026;**
5. **Të ndryshme.**

Përveç pikave që ishin të parapara për shqyrtim, si pikë shtesë hyri:
Propozimi i Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit për ndarjen e parcelës për ndërtimin e objektit për banim social.

Enver Berisha, kryesues: Mirë se keni ardhur në mbledhjen e radhës të Komitetit për Politikë dhe Financa. Besoj se materialin e keni marrë me kohë. Kemi një kërkesë të re që duhet ta trajtojmë sot. Është fjala për një memorandum bashkëpunimi që e kemi bërë

me ministrinë për një lokacion për banim social. Fondet tashmë janë ndarë, ndërsa ka mbetur drejtoria e urbanizmit, bashkë me ekzekutivin, të përcaktojë lokacionin për ndërtimin e banimit të përballueshëm, pasi që rasti i parë ka qenë i nxjerrë nga ky kuvend.
Nuk e di nëse ka dikush diçka për të shtuar rreth rendit të ditës. Kush është për këtë rend dite?

Me 7 vota PËR, u miratua rendi i ditës.

Pika 1. Arsyetimi i mungesave.

Enver Berisha, kryesues: Nuk mungon askush.

Pika 2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e fundit e Komitetit për Politikë dhe Financa.

Enver Berisha: A ka dikush diçka rreth procesverbalit të kaluar? Kush është për?

Me 7 vota PËR, u miratua procesverbali nga mbledhja e kaluar.

Pika 3. Shqyrtimi propozimit të Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit për ndarjen e parcelës për ndërtimin e objektit për banim social dhe ndryshimin e destinimit të shfrytëzimit të tokës.

Enver Berisha, kryesues: Kam kërkuar që fillimisht t'ia japim fjalën drejtorit të Urbanizmit, të na sqarojë kërkesën për lokacionin e ri për ndërtimin e objektit për banim të përballueshëm.

Enver Berisha, drejtor i DUMM: Faleminderit shumë. Përshëndetje për të gjithë të pranishmit. Drejtoria e Urbanizmit ju ka drejtuar juve që t'i rekomandoni kuvendit dy pika. Të dyja kanë të njëjtin qëllim dhe janë të një natyre të ngjashme. Pika e parë është ndarja e parcelës dhe ndërrimi i destinimit të një pjese të parcelës, e cila është zonë e shërbimeve shkollore. Kam dërguar edhe një skicë, e cila e tregon saktësisht ku është vendi dhe çfarë sipërfaqeje duhet të ndahet, te fusha ku është salla e sportit në shkollën e mesme.
Pjesa që është zonë e shërbimeve është një pjesë e madhe e tokës në pronësi të komunës. Kur është bërë zonimi i zonave, asaj i është dhënë destinimi zonë shërbimi, e cila përfshin tregun, shkollën e mesme teknike dhe shkollën fillore. Ne e kemi paraparë që është në kufi të zonës së banimit. Mund t'jua shpërndaj të gjithëve nga një kopje për ta parë saktësisht se ku është vendi dhe sa metra katrorë janë ndarë. Këtu, sa e shoh unë, kemi proceduar 15 ari e

gjysmë, që është e mjaftueshme për një ndërtesë për banim social, në variantin e parë. Variantin e dytë e kemi bërë afër lumit, ku është sot tregu. E kemi bërë 10 ari, me kusht që në të ardhmen ta bëjmë të përballueshëm. Të dyja zonat janë zona të shërbimit, të destinuara për objekte institucionale. E di se institucion është edhe objekti social, mirëpo ne duhet t'i drejtohemi kuvendit që të na japë dritën e gjelbër për të vazhduar me procedurat e tjera. Ne e provuam në Rrafshin e Dukagjinit dhe patëm reagime edhe nga qytetarët. Mirëpo, vend më të përshtatshëm në komunë nuk kemi. Nëse kuvendi e di ndonjë vend më të përshtatshëm, mund të propozohet. Ne jemi në prag të hartimit të Hartës Zonale. Deri në aprovimin e saj është një kohë e gjatë, sepse Harta Zonale mund ta përcaktojë më mirë destinimin e vendeve dhe ta ndryshojë atë, mirëpo koha nuk pret.
Ne kemi bërë një memorandum bashkëpunimi me Ministrinë e Mjedisit, e cila ka zotuar një shumë të caktuar si donacion për banim social. Kështu që kërkoj që ju, si komision, t'i rekomandoni kuvendit që kjo pikë të kalojë dhe të vazhdojmë me procedurën e mëtejme. Faleminderit.

Enver Berisha, kryesues: Faleminderit, drejtor. Besoj se materialin për seancën, së bashku me kopjen e parcelës, do t'ua shpërndani. Besoj tani jemi në rregull. Urdhëro, Esat Raci.

Esat Raci: Faleminderit, kryesues. Përshëndetje për të gjithë të pranishmit. Desha vetëm dy pyetje për drejtorin. Sa është plani dinamik i këtij objekti? A ka diçka konkrete? Si e kemi menduar çështjen e tregut, kur e dini që tregu është një herë në javë? Po ashtu, rreth lumit ose Drinit, a mund të kemi ndonjë telashe me ministritë përkatëse? Faleminderit.

Enver Berisha, drejtor i DUMM: Po, është pyetje me vend. Ne i kemi parë pengesat që mund të hasim. Lumi, me ligj, duhet të ketë një largësi prej 25 ose 30 metrash, por mund të largohet edhe më tej. Ligji në nivel të Kosovës dhe në Hartën Zonale përcakton që nga lumi të largohet 25–30 metra.
Tjetra, neve na është ofruar një sipërfaqe prej rreth 2 metrash katrorë për objektin. Ne mendojmë t'i shtojmë edhe komunat, sepse 2 metra katrorë janë sasi e vogël. Mund të dalin përafërsisht 20 banesa, 20 njësi banimi.
Sa i përket tregut, ky vend nuk është i destinuar për treg. Sipas planifikimit, Hartës Zonale dhe Planit Zhvillimor, ky është vend i shërbimeve.

Esat Raci: Ju e keni obligim dhe përgjegjësi që tregun ta zhvendosni diku tjetër. Sa më kujtohet, a janë tejkaluar disa konteste me qytetarët privatë që kishin prona aty? Këto janë diskutuar më herët, para dy-tri viteve, nëse nuk gaboj. Faleminderit.

Enver Berisha drejtor i DUMM: Nuk kam pasur problem direkt, por jam i njoftuar në mënyrë indirekte. Nuk është pjesë kjo, është shumë më larg. Ajo pjesë është te qendra rinore. Pavarësisht atij problemi për këmbim, kjo është larg. Kjo është te tregu, pjesa ku është sot tregu, por besoj se e ka një distancë të largët.

Enver Berisha, kryesues: Drejtor, edhe njëherë, në emër të KPF-së kërkoj që deri në seancë të sqarohen të gjitha këto dilema që po shfaqen këtu. Është mirë që në seancë të vini të informuar dhe të mos biem në kundërshtim me atë që vendosim këtu.

Enver Berisha, drejtor i DUMM: I nderuar, paraprakisht, para se të vijmë në kuvend, duhet të konsultohemi edhe njëherë me ministrinë. Jemi duke komunikuar me ta.

Enver Berisha, kryesues: Dikush tjetër? Urdhëro, Arben Limani.

Arben Limani: Përshëndetje për të gjithë. Unë jam për ta mbështetur këtë kërkesë, nëse, siç tha drejtori, kemi këto dy mundësi, që të mos na ikë edhe donacioni nga ana e qeverisë. Mirëpo, mendimi im është që brenda hapësirave të shkollave, qysh e përmende drejtor, varianti pas palestrës të mos jetë, për shkak se aty është duke u ndërtuar një çerdhe. Mendoj se çerdhja dhe hapësirat e parkingjeve që mund të bëhen aty për çerdhen, për prindërit dhe ndonjë kënd lojërash, e kufizojnë shumë hapësirën e shkollave.
Mundësia e një palestre sportive, të cilën shkolla "Motrat Qiriazi" nuk e ka, duhet të merret parasysh, pasi të gjitha shkollat duhet t'i kenë palestrat. Kështu kufizohet dhe ngushtohet hapësira e objekteve arsimore.
Për hapësirën e tregut, nëse na vini me një propozim konkret edhe për mundësinë e zhvendosjes së tregut, dhe ekspertët e vlerësojnë si hapësirë të përshtatshme, atëherë unë jam më shumë për këtë variant. Brenda hapësirave të shkollës të mos ndërtohet, pasi aty është edhe çerdhja e fëmijëve. Mendoj se shkolla duhet ta ketë hapësirën që e ka sot dhe të shqyrtohet varianti tjetër, te tregu. Faleminderit.

Valmir Baca: Faleminderit, kryesues. Me sa po e kuptoj, afati i fundit është se në seancën e ardhshme duhet të merret vendim për lokacionin. Edhe unë pajtohem që të marrim më shumë informata në seancën e ardhshme, sa hapësira mbeten në shkollë, sa për çerdhen dhe shkollën e mesme, dhe pastaj ta diskutojmë përsëri.
Me sa kam parë në komunat tjera, të gjitha procedurat, edhe të ndërtimit edhe të planifikimit, i kryen ministria për ndërtimin e këtij objekti të banimit social. Besoj se në seancë do të kemi më shumë informata rreth kësaj teme dhe qëndrimin do ta japim edhe në seancë.

Enver Berisha, drejtor i DUMM: Po, i nderuar. I kemi paraparë të gjitha rrethanat që të mos ngushtohet oborri i shkollës. E kemi një pjesë pas sallës sportive, e cila ndahet nga një vijë e ujit. Vija e ujit është pronë e ujit dhe menaxhohet nga Kompania Rajonale "Drini i Bardhë". Na është dukur e përshtatshme, sepse te pronat publike të ujërave mund të afrohen deri në pikën zero në kufi. Janë disa rrethana lehtësuese në Hartën Zonale, e cila na ofron këtë pjesë deri te pika zero, te vija e ujit. Ajo mund të përdoret si parcelë.
Ndërsa pjesa te tregu është nën rrugë dhe nuk hyn fare në oborrin e shkollës, pasi ne i kemi ndarë për çerdhe 30 e diçka ari.

Enver Berisha, kryesues: Faleminderit, drejtor. Urdhëro, nënkryetari e ka fjalën.

Fadil Gashi, nënkryetar: Faleminderit, kryesues. Përshëndetje për ju dhe të gjithë të pranishmit. Ne kemi bërë konsultime, takime dhe mbledhje të bordit dhe janë analizuar të gjitha mundësitë, edhe terreni edhe variantet. Këto janë variantet.
Ne e kemi nënshkruar memorandumin me ministrin. Në atë takim janë 1 milion e 865 mijë euro, me njësi, siç po i prezanton edhe drejtori. Nuk zgjerohet asnjë pronë tjetër. Në variantin e parë e humbëm dhe u desh t'i anulonim vendimet.

Është edhe një kriter tjetër që, sipas ministres, nuk mund të dalim jashtë zonës urbane. Zona urbane na i jep këto mundësi dhe ne nuk mund të tërhiqemi prej tyre. Tash, për pronën, ne nuk po marrim pronë të shkollave. Realisht, pronat e shkollave janë pronë e jona. Ju keni shembuj që kemi bërë shumë bartje të pronave për shkak të implementimit të projekteve. Po dua të them që është mirë ta mbështesim dhe të fillojmë. Të gjitha procedurat tjera në këtë projekt do t'i udhëheqë komuna. Të gjitha do të kalojnë edhe përmes jush, edhe përmes institucioneve lokale dhe qendrore që do të jenë pjesë e këtij projekti të përbashkët.
Veç mos ta humbim dhe të fillojmë sa më shpejt me implementimin e këtij projekti.
Faleminderit.

Enver Berisha, kryesues: Faleminderit, nënkryetar. A ka dikush tjetër rreth kësaj pike?

Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të propozimit të Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, me 7 vota PËR, rekomandoi që propozimi të kalojë për shqyrtim dhe miratim në Kuvend. Po ashtu, rekomandoi që drejtoria në fjalë të sjellë propozimin, duke sqaruar në detaje propozimin lidhur me këtë projekt.

Pika 4. Shqyrtimi i draft-buxhetit komunal për vitin 2027.

Enver Berisha, kryesues: Drejtori i Financave e ka fjalën. Urdhëro, z. Faruk Smajli.

Faruk Smajli, drejtor i Financave: Faleminderit, kryesues. Të nderuar të pranishëm, sot para jush paraqesim buxhetin e komunës për vitin 2027. Pas pranimit të qarkores së dytë buxhetore, e cila na ka përcaktuar kufijtë përfundimtarë buxhetorë, komuna duhet ta planifikojë buxhetin e saj. Gjatë përgatitjes së buxhetit janë shqyrtuar kërkesat e drejtorive komunale, kërkesat e qytetarëve të paraqitura në procesin e dëgjimeve buxhetore dhe projektet kapitale të vlerësuara si prioritare për vitin 2027.
Buxheti për vitin 2027 është gjithsej 16 milionë e 845 mijë e 517 euro. Pjesa më e madhe shkon për paga dhe mëditje, në vlerë prej 10 milionë e 182 mijë e 134 euro. Pjesa tjetër është për mallra dhe shërbime, rreth 1 milion e 600 mijë euro, shpenzime komunale 370 mijë euro, subvencione 800 mijë euro, si dhe investime kapitale në vlerë prej 3 milionë e 893 mijë e 383 euro.
Në krahasim me kufijtë e përcaktuar të Kornizës së Parë Buxhetore, investimet kapitale janë zvogëluar për 380 mijë euro. Këto mjete janë orientuar në paga dhe mëditje si rezultat i përcaktimit të kufijve buxhetorë në qarkoren e dytë. Pra, kemi kufizim të hapësirës financiare për investime kapitale. Për këtë arsye, gjatë hartimit të draft-buxhetit, projektet kapitale janë renditur sipas prioriteteve dhe nevojave më urgjente të komunës. Ne kemi punuar së bashku me qytetarët për të përcaktuar cilat projekte janë më urgjente dhe cilat duhet të kenë përparësi në kuadër të mjeteve të disponueshme. Materialin besoj se e keni marrë me kohë. Nëse keni diçka, jam këtu.

Enver Berisha, kryesues: Faleminderit, drejtor. Unë e hap debatin.

Esat Raci: Faleminderit, kryesues. Deshta t'ju bëj një pyetje juve personalisht. Më ra në sy ndërtimi i rrugës mbitokësore dhe nëntokësore Jashanicë–Jellovc–Resnik. Meqë jeni qeveri e terrenit, a keni dalë në terren për këtë rrugë dhe a mjaftojnë 30 mijë euro?

Enver Berisha, kryesues: Esat, pa incizim të terrenit, dije që asnjë projekt nuk hyn në rend dite dhe nuk hyn në buxhet për vitin 2027. Te pjesa e buxhetit është e vërtetë që jo gjithmonë janë të planifikuara të gjitha mjetet për një projekt, por për t'u realizuar në vitin 2027 duhet të ndahet një shumë. Mundësinë për mjete të tjera e ke gjatë vitit, të cilat mund t'i shtosh dhe ta realizosh projektin. Por, për ta koduar projektin, duhet të parashihet një shumë. Jam i vetëdijshëm që nuk mjafton ajo shumë, por për t'u realizuar projekti duhet të parashihen edhe mjetet shtesë. Faleminderit. Dikush tjetër?

Esat Raci: Ne do t'i themi në seancën që vjen mendimet tona. Pajtohem me këto që po i thua, por ajo rrugë duhet të rregullohet prej fillimit, sepse është dëmtuar shumë. Faleminderit.

Enver Berisha, kryesues: Sinqerisht e kam, jo vetëm ju, Esat, por komplet anëtarët që jemi në këtë komitet, bashkë me grupet parlamentare, vlerësoni, mendoni dhe shikoni propozimin e ofruar dhe çka kemi për të shtuar. Jam shumë i vetëdijshëm që të gjithë që jemi këtu jemi në emër të qytetarëve që na kanë dhënë votën dhe jemi të obliguar t'i përfaqësojmë dhe të realizojmë projektet për ta. Dikush tjetër? Urdhëro, Valmir Baca.

Valmir Baca: Faleminderit, kryesues. Draft-buxheti i komunës së Klinës për vitin 2027 është përgatitur pas konsultimeve të nevojshme me të gjitha grupet e interesit, dëgjimeve buxhetore, kryetarëve të bashkësive lokale dhe Asamblesë së Fëmijëve. E kam parë edhe dëgjimin e fundit që është bërë. Është një buxhet që, krahas mundësive që janë, ka përfshirë projektet e nevojshme. E dimë që buxheti nuk është i mjaftueshëm për t'i realizuar të gjitha projektet, por konsiderojmë se janë marrë për bazë kërkesat e qytetarëve. Do ta kemi edhe raportin e komisionit, në bazë të kërkesave të bëra në dëgjimet buxhetore, cilat kërkesa kanë hyrë në buxhet dhe cilat kanë qenë të pamundura të futen. Kështu që vota jonë do të jetë pro në seancën e ardhshme. Faleminderit.

Enver Berisha, kryesues: Faleminderit. Po e ndiej obligim të them se kufijtë buxhetorë nuk i caktojmë ne, por niveli qendror. Në bazë të kufijve që na cakton niveli qendror, ne duhet të përballemi me ta. Urdhëro, Teuta Mulaj.

Teuta Mulaj: Faleminderit, kryesues. Përshëndetje për të gjithë. Kam marrë disa kërkesa nga qytetarët dhe do të mundohem t'i paraqes me shkrim, ashtu siç e kërkon rregulli.
Disa prej tyre janë: rregullimi i pllakës përkujtimore në Klinë, te sheshi i Skënderbeut, që për shkak të historisë së luftës dhe gjurmëve që ka lënë lufta e fundit, është mirë të investohet pak aty që të duket më mirë.
Ndriçimi publik në lagjen "Smajl Bashota" do të kishte qenë shumë i nevojshëm. E kemi futur në lagjen "Azem Desku", por e di që është duke u bërë edhe çështja e rrugës, e cila është bërë shumë e keqe.
Gjithashtu, ndriçimi në fshatin Gjurgjevik i Madh, në lagjen Zeqir Mërturi, dhe ndërtimi i rrugës në fshatrat Zllakuqan, Leskoc dhe Ranoc. Ndoshta edhe këto do të ishte e arsyeshme

të përfshihen.
Një tjetër kërkesë që është në planifikim të buxhetit është rruga në fshatrat Jashanicë, Jelloc dhe Resnik. Faleminderit.

Enver Berisha, kryesues: Faleminderit, zonja Mulaj, për informacionin. Rruga juaj ka hyrë në projekt, d.m.th. është ndarë buxheti, ashtu siç ka premtuar edhe kryetari. Edhe ndriçimi nuk është problem të realizohet. I përgatit për seancë edhe me shkrim dhe i sjell edhe në asamblenë komunale. Urdhëro, Arben Limani.

Arben Limani: Është diskutuar shumë tema e ujit të pijshëm në Klinë, mirëpo për këto tri vjet të ardhshme, çfarë mendohet të bëhet për ta zgjidhur këtë çështje? Është e tepërt që në vitin 2026 të mos kemi ujë të pijshëm. Ndoshta është dashur të shfrytëzohen edhe donacionet ose fondet, ose të lihen projektet tjera dhe të zgjidhet ky problem që është jetik.

Enver Berisha, kryesues: Faleminderit, Arben. Sa kam informacion, kryetari është takuar me një këshilltare të kryeministrit, e cila ishte me prejardhje nga Klina. Një prej çështjeve të diskutuara ishte edhe çështja e ujit të pijshëm. Ndoshta zonja Mulaj e di këtë çështje. Ajo ka dhënë garancë se për projektet që ka nevojë Klina, do të ndahen mjete. Ndër to është edhe uji i pijshëm. Nuk mund ta them tani se kur do të ndodhë, por kjo çështje është biseduar dhe janë marrë garanci nga këshilltarja. A ka dikush tjetër?

Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të draft-buxhetit komunal të Klinës për vitin 2027, me 7 vota PËR, rekomandoi që i njëjti të kalojë për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.

Pika 5. Shqyrtimi i kërkesave të pranuara në Komitetin për Politikë dhe Financa gjatë periudhës korrik-gusht 2026.

Kërkesa 1.
Kërkesë e parashtruar nga z. Sami Gashi nga fshati Qupevë, i cili thekson se posedon në shfrytëzim 4 ari, pjesë nga parcela me numër 102-0, ZK Qupevë, andaj kërkon që kjo pjesë e parcelës t'i legalizohet, pasi që i nevojitet për ndërtimin e shtëpisë.

Enver Berisha, kryesues: A ka nevojë për debat apo po e rekomandojmë së bashku me kërkesat tjera? Kush është për?

Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të kërkesës së parashtruar nga z. Sami Gashi, me 7 vota PËR, rekomandoi që ajo t'i përcillet Zyrës së Kryetarit të Komunës së Klinës për shqyrtim dhe veprim të mëtejmë, në përputhje me Ligjin Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të

Komunës dhe Rregulloren (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimit të Pronës së Paluajtshme të Komunës.

Kërkesa 2.
Kërkesë e parashtruar nga z. Martin Rrustemi, përmes avokatit të autorizuar, z. Alban Krasniqi, i cili kërkon të realizohen pagesat e mëditjeve për z. Martin Rrustemi për punën e kryer si anëtar i Komitetit, për çdo vit të mandatit, deri në gjashtë (6) mbledhje për vit, për tërë periudhën e ushtrimit të detyrës si anëtar i Komitetit Konsultativ për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Mbrojtje të Mjedisit.
Shuma e kërkuar për një mbledhje të jetë e barabartë me atë të anëtarëve të komiteteve të përhershme (KPF), si bazë referente për llogaritjen proporcionale sipas nenit 14.2 të UA 01/2016, së bashku me aktin që e përcakton këtë shumë.
Po ashtu, kërkon që t'i sigurohen të dhënat zyrtare mbi numrin e mbledhjeve të mbajtura të Komitetit dhe pjesëmarrjen e z. Martin Rrustemi për secilin vit të mandatit.

Enver Berisha, kryesues: Dua t'ju them diçka në mënyrën më të sinqertë. Unë kam mbajtur tri takime me kryesuesit e komunave të regjionit dhe e vetmja komunë që i paguan komitetet joobligative, d.m.th. jashtë KPF-së, është komuna e Rahovecit, me nga 50 euro.
Asnjë komunë tjetër nuk i paguan. Ne e kemi caktuar një takim ku do të jetë edhe ministria, pikërisht për çështjen e pagesës së komiteteve, por sot nuk mund t'ju them se çfarë vendimi do të merret, pasi takimi ende nuk është mbajtur.
Ne jemi zotuar për këto pagesa, por deri tani është e pamundur të paguajmë. Dje patëm një kërkesë nga Drejtoria e Administratës për rregullimin e kioskës këtu, e cila nuk po funksionon. U desh që nga buxheti i kuvendit të huazohen paratë, sepse nuk ka mjete.
Kështu që, jemi në vështirësi për realizimin e kërkesave tona të mëvonshme, mirëpo besoj se gradualisht do t'i tejkalojmë këto pengesa.
E njëjta kërkesë është edhe për Martin Rrustemin, për komitetin. D.m.th., nuk mund të bëjmë seleksionim dhe ne si kuvend nuk mund t'u ofrojmë zgjidhje përderisa nuk ka zgjidhje për të tjerët. A ka dikush? Urdhëro, nënkryetar.

Fadil Gashi, nënkryetar: Po kyçem pak, meqë kam qenë pjesë e shumë aktiviteteve, por nuk kemi mundur të gjejmë zgjidhje për komitetet tjera dhe trupat që janë jashtë komiteteve. Kemi edhe dy komitete tjera konsultative profesionale.
Nuk është vetëm Martini dhe trupat tanë, por kjo është çështje në nivel të Kosovës. Kemi obligim t'i paguajmë. Çështja është se si të gjejmë një zgjidhje për pagesën e këtyre trupave. Edhe në të kaluarën kemi pasur dilema të tilla. Kur i themelon kuvendi, e merr përgjegjësinë, sepse rregullorja për themelimin dhe përgjegjësitë në përbërjen e komiteteve e ka një pjesë që thotë se kompensohen. Edhe sot kemi telashe. P.sh., KKSB-në e kemi mbajtur pas orës 16:00 dhe për mua nuk është në rregull. Këtë situatë e ka shkaktuar edhe ligji për paga. Para fillimit të ligjit për paga, ata që kanë pasur mandatet e mëparshme e kanë parë se kemi filluar t'i paguajmë dhe filluan pagesat.
Me implementimin e ligjit për paga në sektorin publik, kjo pjesë u deformua. Nuk është në pyetje mbështetja e kërkesës, por gjetja e një zgjidhjeje, ndoshta përmes drejtorisë,

ekzekutivit, kryesuesit dhe të gjithëve, duke e përdorur edhe kolegjiumin e kryesuesve, për të gjetur një zgjidhje të përhershme. Faleminderit.

Enver Berisha, kryesues: Faleminderit, nënkryetar. Dikush tjetër? Atëherë, kush është për?

Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të kërkesës së parashtruar nga z. Martin Rrustemi, përmes avokatit të tij të autorizuar, z. Alban Krasniqi, me 7 pika PËR, rekomandoi që kërkesa të dërgohet për shqyrtim në Drejtorinë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim.

Pika 6.Të ndryshme.

Enver Berisha, kryesues: A ka dikush diçka në të ndryshme? Nëse jo, ju falënderoj për kohën dhe angazhimin tuaj. Shihemi në seancën e radhës.

Procesmbajtësja
Monika Palushi Gojani

REPUBLIKA E KOSOVËS · REPUBLIC OF KOSOVO · KOMUNA E KLINËS · MUNICIPALITY OF KLINA · OPSTINA KLINA · REPUBLIKA KOSOVA

KRYESUESI
z. Enver Berisha